



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.137, datë 02.06.2022

PËR

**“CAKTIMIN ME SHORT TË RELATORIT PËR PROCEDURËN E VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE FIGURËS PËR KANDIDATIN QË KA KANDIDUAR PËR POZICION DREJTUESI, I SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 125, DATË 26.05.2022, TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË”**

Bazuar në nenet 159, pika 1, 161 dhe 190, pika 2, të ligjit Nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në pikat 2 deri 7, të nenit 32, në pikat 7 dhe 8, të nenit 48, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në pikën 2, Seksioni A, Kreu V, të Rregullores “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe për zhvillimin e karrierës së prokurorëve” i ndryshuar, në nenin 9, pika 4, të Rregullores “Për miratimin e rregullores mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, si dhe pasi u njoh me relacionin e Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, për caktimin me short të relatorit për procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatin që ka kandiduar për pozicion drejtuesi, të shpallur me vendimin Nr.125, datë 26.05.2022, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

**VENDOSI:**

1. Caktimin me short të relatorit për procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës për kandidatin që ka kandiduar për pozicion drejtuesi, të shpallur me vendimin Nr.125, datë 26.05.2022, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si më poshtë:

Arens Çela kandidat për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë,

- Relator, zoti Ludovik Dodaj.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
  3. U shpall në Tiranë, sot më 02.06.2022.



## KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



**KRYETAR**  
**Alfred Balla**

**ANËTAR**  
**Sokol Stojani**

**ANËTAR**  
**Eloida Goxhi**

**ANËTAR**  
**Zeqir Hoda**

**ANËTAR**  
**Bujar Sheshi**

**ANËTAR**  
**Esmeralda Keshi**

**ZV/KRYETAR**  
**Tartar Bazaj**

**ANËTAR**  
**Nurihan Seiti**

**ANËTAR**  
**Ludovik Dodaj**

**ANËTAR**  
**Mirela Bogdani**